

KËSHILLI MINISTROR I KOMUNITETIT TË ENERGJISË

KONKLuzionet nga Takimi

Mali i Zi, 29 Qershor 2007

1. Ministrat e Komunitetit të Energjisë falenderuan Ministrin e Malit të Zi dhe autoritetet e tjera për mikëpritje.
2. Pikat A në Shtojcën 1 u miratuan.
3. Këshilli i Ministrave njohu Holandën si pjesmarrëse në pajtim me Nenin 95 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
4. Në pajtim me konkluzionin 9 të Ekzekutivit të Shkupit më 17 Nëntor 2006, Komisioni Evropian bëri një raport mbi qëllimet dhe gjendjen e diskutimeve me Ukrainën, Moldovën, Norvegjinë dhe Turqinë. Sa i përket Ukrainës, Norvegjisë dhe Moldovës, Komisioni Evropian ka rekomanduar një fillim më të hershëm të procesit të qasjes formale dhe ceku se Turqia për një kohë të gjatë është konsideruar si aplikues i kualifikuar. Në atë rekomandim, Ekzekutivi kërkoi nga Komisioni që të vazhdojë të koordinojë procesin e hyrjes së katër shteteve. Megjithatë, ekzekutivi përfshirë këtu Komunitetin Evropian theksuan se në këtë proces hyrës, duhet respektuar procedurat relevante të brendshme të Palëve ekzistuese të Traktatit.. Ekzekutivi Dëshiron një proces të shpejtë hyrës me qëllim që Ukraina, Norvegjia dhe Moldova të pranohen në Traktat gjatë vitit 2007 duke u siguruar se plotësohen kushtet paraprake. Ekzekutivi ftoi Turqinë që të bëhet anëtare e plotë e Komunitetit të Energjisë. Për sa i përket procesit hyrës, ekzekutivi theksoi çështjet vijuese:
 - Tregjet rajonale të definuara nën Titullin III të Traktatit të Komunitetit të Energjisë duhet të jenë në përputhje me pronat gjeografike dhe fizike të integritetit të Palëve kontraktuese në Tregjet e brendshme të gazit dhe energjisë elektrike të Komunitetit Evropian.
 - Në një Komunitet të zgjeruar të Energjisë, nevoja për të diskutuar mekanizmat rregulluese ndërmjet palëve do të duhet të vlerësohet. Për më tepër një proces formal që ekziston në një nivel më poshtë se ai Ministror do të duhet të mirret parasysh për çështjen e mos implementimit të obligimeve nga Palët e Traktatit.
5. Ekzekutivi (ministrior) i Komunitetit të Energjisë kërkon nga GPNL që të përpilojë një listë të projekteve infrastrukturore prioritare për Palët Kontraktuese duke shfrytëzuar kriteret e caktuara nga European Unions Trans-European Networks – Programi për Energji (TEN-E). Ekzekutivi (ministrior) mirëpret Konferencën e ardhshme për investime në Athinë.

6. Ministrat miratuan Raportin e 1rë vjetor mbi aktivitetet e Komunitetit të Energjisë në pajtim me Nenin 52 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, dhe autorizuan Sekretariatit që ta dorëzojë atë në emër të Ekzekutivit (ministror) në Parlamentin Evropian dhe në Parlamentet e Palëve bashkëngjitëse dhe pjesmarësve përkrahës.
7. Ministrat shqyrtuan gjendjen e implementimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Në këtë aspekt, Këshilli i Ministrave theksoi progresin e shënuar si dhe sfidat që Palët Kontraktuese janë ballafaquar përgjatë implementimit. Edhe një herë u cek rëndësia e procesit të monitorimit të obligimeve nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Ministrat u pajtuan që ta shqyrtojë situatën në Nëntor dhe të ekzaminojnë mundësinë e dhënies së një periudhe shtesë për t'u mundësuar atyre Palëve që nuk kanë arritur ti kryejnë obligimet e tyre për ta zhvendosur legjislacionin e tyre vendor në pajtim me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Nga Sekretariati kërkohet që të përqëndrohen në këtë çështje deri në takimin e ardhshëm të Ministrave dhe të dorëzojnë një raport të shkurtë.
8. Sa i përket sigurisë së furnizimit, dhe në pajtim me Nenin 100 (ii) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ekzekutivi (ministror) u pajtua që të implementojë:
 - Direktivën 2005/89/EC në lidhje me masat për siguri të furnizimit me energji elektrike dhe investimet infrastrukture; dhe
 - Direktivën 2004/67/EC në lidhje me masat për siguri të furnizimit me gaz natyror; dhe
 - Rregulloren 1775/2005/EC mbi kushtet e qasjes në rrejtet bartëse të gazit natyror.

Nga GPNL kërkohet që të propozojë në takimin e ardhshëm të Ministrave, amandamentet adekuate të Nenit 10 & 11 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe të caktojë afate kohore për implementim.

Nga Komisioni Evropian kërkohet që të ekzaminojë mjetet adekuate për të siguruar kordinim të afërt të organeve relevante të themeluara nga këto Direktiva dhe Rregullore përbrenda Komunitetit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë dhe/apo bashkimit të këtyre dy organeve.

Sa i përket obligimeve specifike ligjore që dalin nga Neni 46 i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që do të thotë miratimi i një akti procedural për operimin e obligimit për asistencë të ndërsjellë, Ekzekutivi (ministror) u pajtua që limiti kohor në Nenin 46 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të shtyhet në 3 vite, në pajtim me Nenin 100 (i) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në mënyrë që të lejohet reflektim i mëtejshëm i kësaj dispozite shumë teknike e politike.

Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ka për detyrë të përpilojë një raport mbi Nenet 44-46 për takimin e ardhshëm të Ministrave duke reflektuar mendimet e Palëve Kontraktuese.

9. Ministrat falenderuan Presidencën aktuale të Komunitetit të Energjisë dhe i uruan mirëseardhje Presidencës pasuese, Serbisë. Ministrat konkluduan se prioritet për Presidencën pasuese është të sigurihet se Palët me sukses janë duke arritur obligimet nga Traktati nga zhvendosja deri në implementimin efektiv.
10. Sa i përket Memorandumit Social, Këshilli i Ministrave u pajtua me përmbajtjen e këtij Memorandumi. Kjo e fundit do të jetë e hapur për nënshkrime qysh nga Tetori 2007. Komisioni shprehi gatishmërinë e Komunitetit Evropian për të nënshkruar këtë Memorandum. Nga GPNL u kërkua që në takimin e ardhshëm Ministror të paraqesin opsione të ndryshme për themelimin e një forumi që do jetë përgjegjës për adresimin e çështjeve sociale.

Këto konkluzionë janë miratuar.

Për Këshillin e Ministrave

PRESIDENCA

Shtojcë

- 1) Ekzekutivi (ministrior) miratoi Konkluzionet e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë për periudhën e Presidencës nga Qeveria e Malit të Zi.
- 2) Në pajtim me Nenin 74 të Komunitetit të Energjisë, ekzekutivi miratoi propozimin për buxhet (me një tavan buxhetor prej 2.032 milion Euro) të paraqitur –në pajtim me Nenin 47(c) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë – Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë (GPNL) të miratoi Aktin e kërkuar Procedural para fundit të Gushtit 2007.
- 3) Ekzekutivi (ministrior) në pajtim me Nenin III.3 të Vendimit të Këshillit Ministror të 17 Nëntorit 2006 mbi miratimin e rregullave të rekrutimit, kushteve të punës dhe ekuilibrit gjeografik të stafit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (2006/02/MC –EnC), miraton Organogramin e Sekretariatit për periudhën Korrik-Dhjetor 2007.
- 4) Drejtori i Komunitetit të Energjisë ftohet të dorëzojë një raport mbi Nenin 75 për periudhën që nga hyrja në fuqi e Traktatit deri në fillimin e periudhës së ardhshme buxhetore në takimin e ardhshëm të Ministrave (Korrik 2006 – nëntor 2007)
- 5) Në pajtim me Nenin 66 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Forumi i Gazit do të takohet në Maribor. Ekzekutivi (ministrior) – në pajtim me Nenin 47(c) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë – Grupi Permanent i Nivelit të Lartë (GPNL) të miratojë Aktin e kërkuar Procedural para fundit të Gushtit 2007.
- 6) Në pajtim me Nenin 21 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Ekzekutivi (ministrior) miratoi listën e standardeve të aplikueshme në përgjithësi për gaz dhe energji elektrike. Ekzekutivi (ministrior) – në pajtim me Nenin 47(c) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë – Grupi Permanent i Nivelit të Lartë (GPNL) të miratojë Aktin e kërkuar Procedural para fundit të Gushtit 2007.